



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Datë: 28.02.2025
Numër Protokolli: 1711/2025

A.nr.98/2025

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.98/2025, të datës 15.01.2025, të parashtruar nga ankuesja E.R, kundër organit të punësimit: Agjencia e Kosovës për Akreditim, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.98/2025, e datës 15.01.2025, e parashtruar nga ankuesja E.R, në atë mënyrë që aprovohet si bazuar pretendimi lidhur me realizmin e pagës së realizuar para transferimit të përhershëm, ndërsa, refuzohet pretendimi ankimor lidhur me klasifikimin e pozitës së ankueses në kategorinë drejtues i ulët dhe më koeficient 7.24 të pagës.

II. Mbetet në fuqi Akt Emërimi i ankues 1504/2024 i datës 02.08.2024.

III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm dhe Njësia e Personelit në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ndërmarrin veprimet e nevojshme administrative, ashtu që ankueses t’i njihet e drejta në shtesë tranzitore dhe të njëjtës t’i bëhet kompensimi i difference së papaguar të shtesës tranzitore nga muaji gusht 2024 e deri në zbatimin e këtij vendimi, si në arsyetim të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet lidhur me veprimet e ndërmarra në zbatim të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile E.R (*tutje referuar vetëm si: ankuesja*), më datë 14.01.2025, në mënyrë elektronike (ankesa.kpmschck@rks-gov.net), ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 15.01.2025 nën shenjen A.nr.98/2025, kundër Përgjigjes me numër protokolli 2554/24 të datës 13.12.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të

Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për shkak të interpretimit të gabueshëm, dhe jo të plotë të dispozitave ligjore, vërtetimit jo të plotë të provave materiale dhe diskriminimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 20.01.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Kosovës për Akreditim, ndërsa, kjo e fundit, më datë 27.01.2025, ka dorëzuar përgjigjën në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin në vijim Kolegji i Këshillit administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 177/2025 të datës 15.01.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen me numër protokollit 2554/24 të datës 13.12.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Akreditim; Marrëveshjen për transferim të përhershëm me numër protokollit 1433/24 të datës 18.07.2024; Vendimin për transferimin e përkohshëm i datës 29.07.2024; Akt Emërimit të datës 03.02.2020; Akt Emërimit me Nr. 1504/2024 të datës 02.08.2024; Kërkesën e datës 22.11.2024 nga ankuesja për Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Akreditim; Emailin e datës 16.12.2024 nga ankuesja për B.R; Emailin e datës 05.12.2024 nga V.C për S.C; Certifikatën me Nr. 239/2018 të datës 05.11.2018; Vërtetimin e datës 07.03.2024; Kopjen e ID-së së ankuses; Emailin e datës 14.01.2025 nga ankuesja për ankesa.kpmschck@rks-gov.net; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 20.01.2025; Përgjigjën në ankesë e datës 27.01.2025; Listën e pagave për muajin korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor 2024 për ankuesen.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë si dhe pretendimeve ankimore të ankuses ka gjetur se ankesa **është pjesërisht e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë se ankuesja sipas Akt Emërimit 02/01-112/01-0009357/20 të datës 03.02.2020, ka qenë e punësuar në pozitën Zyrtare Certifikuese në Komunën e Mitrovicës së Jugut, ndërsa, sipas Marrëveshjes për transferim të përhershëm me numër protokollit 1433/24 të datës 18.07.2024, mes Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe Komunës së Mitrovicës së Jugut, e njëjta është transferuar në mënyrë të përhershme në pozitën Zyrtare Certifikuese në Agjencinë e Kosovës për Akreditim. Rrjedhimisht, si rezultat i kësaj marrëveshje, ankuses ka nënshkruar edhe Aktin e Emërimit Nr.1504/2024 të datës 02.08.2024, kategoria Profesional 1, klasa dhe koeficienti i pagës I12, 5.75.

Ankuesja më datë 22.11.2024, ka parashtruar kërkesës tek Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kosovës për Akreditim, me të cilën ka kërkuar eliminimin e diskriminimit sa i përket pagës, ngase pozita e Zyrtarit Certifikues në institucionet qendrore dhe lokale është pozitë e nivelit të ulët drejtë dhe si e tillë jam trajtuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut me koeficient të pagës 7.35, duke kërkuar që kështu të trajtohet edhe në Agjencinë e Kosovës për Akreditim.

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kosovës për Akreditim, përmes përgjigjes me numër protokollit 2554/24 të datës 13.12.2024, ka njoftuar ankuesen se Rregullorja (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, pozitën Zyrtar Certifikues e përcakton si pozitë të kategorisë profesional 1 e jo të kategorisë së ulët drejtuese, ndryshe nga Rregullorja (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, andaj, edhe paga është duke u realizuar konform dispozitave ligjore në fuqi.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se pagën në Komunën e Mitrovicës së Jugut për pozitën përkatëse e ka marr me koeficient 7.35, ndërsa pas transferimit e njëjta është ulur në koeficientin 5.75 dhe krejt kjo në kundërshtim me normat ligjore, sepse e drejta në pagë është e drejtë e fituar, fakt ky i konfirmuar

nga Gjykata Kushtetuese. Shton së pozita zyrtar i lart certifikues është klasifikuar si drejtues i ulët me koeficient 7.24. Kërkon që Këshillit të aprovoj ankesën dhe të obligoj Agjencinë e Kosovës për Akreditim të klasifikoj ankuesin në koeficient 7.24 dhe ti paguaj në mënyrë retroaktive diferencën e mjeteve të ndaluara nga transferimi në AKA.

Kolegj i Këshillit nga analizim i provave materiale të çështjes ka konstatuar së ankuesja sipas Aktit të fundit të emërimit të datës 10.01.2022, ka ushtruar pozitën e punës Zyrtar Certifikues në Komunën Mitrovicë, me koeficient 8 të pagës, pas hyrjes në fuqi të ligjit për paga Nr. 08/L-196, e deri në transferimin e saj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ka realizuar koeficient të pagës GJ 3, 7.26, ndërsa, pas transferimit ankuesja realizon koeficient të pagës Il2, 5.72.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: *''1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj''*, dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: *3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, kurse klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.*

Në ndërlidhje me konstatimin si më sipër, Kolegji analizoj nenin 38 paragrafi 2, të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më të cilin është përcaktuar: *2. Pozitat në shërbimin civil ndahen në këto kategori: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese që përfshin: sekretaren/in e përgjithshëm, drejtoresh/in e përgjithshëm në agjenci të pavarur dhe rregullatore, drejtoresh/in ekzekutiv dhe zëvendësdrejtoresh/in e një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme me to; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese që përfshin pozitën e drejtoresh/it të departamentit dhe pozitën e barasvlershme me të; 2.3. **Kategoria e ulët drejtuese që përfshin pozitën e udhëheqës/it të divizionit dhe pozitën e barasvlershme me të;** 2.4. Kategoria e specialistëve që përfshin profesionistë në fusha që kërkojnë përgatitje specifike; dhe 2.5. Kategoria profesionale që përfshin zyrtarët profesional'', rrjedhimisht në kuptim të kësaj bazë ligjore rezulton së në kategorinë e ulët drejtuese përfshihen vetëm pozitat e udhëheqësve të divizionit dhe pozitave të barasvlershme.*

Duke ju referuar, pretendimit ankimor së pozita Zyrtar Certifikues në institucione publike klasifikohet si pozitë e nivelit të ulët drejtues, Kolegji thekson faktin së Rregullorja (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, e cila ka hyrë në fuqi më datë 30.12.2022 në Shtojcën Nr.1/5 ka përcaktuar se: *''Pavarësisht përcaktimeve të kësaj kategorie, për qëllim të klasifikimit pozita e certifikuesit konsiderohet si pozitë ekuivalente me drejtuesin e ultë në institucionin përkatës. Detyrat dhe përgjegjësitë e certifikuesit përcaktohen me legjislacionin relevant në fuqi''*, mirëpo, kjo rregulle është shfuqizuar më hyrjen në fuqi me datë 28.02.2024 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, e sipas së cilës me nenin 13 parashihet se: *Klasat përbërëse të kategorisë së ulët drejtuese dhe emërtesat e lejuara për secilën klasë janë: Drejtues i Ulët 1. Udhëheqës i Divizionit në Zyrën e Kryeministrit; 2. Udhëheqës i Divizionit në një Ministri; 3. Udhëheqës i Divizionit në Agjenci të Pavarur; 4. Udhëheqës i Divizionit në Agjenci të Pavarur dhe në Agjenci Rregullatore; 5. Udhëheqës i Divizionit/Sektorit në Agjenci Ekzekutive dhe Komuna, ndërsa, nuk ka trajtuar fare klasifikimin e*

pozitës së Zyrtarit Certifikues, andaj, nga kjo bazë ligjore rezulton së pozitën në shërbim civil përfshirë edhe pozitën Zyrtar Certifikues, klasifikohen vetëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, rrejdhimisht, nisur nga kuadri ligjor si dhe duke u bazuar edhe në Katalogun e Vendeve të Punës i miratuar me vendimin nr. 08/226, datë 23.10.2024, të Qeverisë së Kosovës, rrjedhë së pozita Zyrtar Certifikues, klasifikohet si pozitë e kategorisë profesionale, klasa profesional 1, ndërsa, paga dhe komponent e saj përcaktohen në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. Andaj, mbi këtë bazë rrjedhë së nuk ka mbështetje ligjore pretendimi ankimor i ankueses së pozita e saj si Zyrtare Certifikuese duhet të klasifikohet si pozitë e nivelit të ulët drejtues dhe me koeficient 7.26.

Në fakt, duke qenë së Rregullorja (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, pozitën Zyrtar Certifikues e ka klasifikuar si pozitë të nivelit të ulët drejtues, në këtë rast ankuesja në muajin janar 2023 si zyrtare certifikuese në Komunën e Mitrovicës duhej të realizonte koeficienteve të pagës të aplikueshëm sipas Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, të barasvlershme me pagën e udhëheqësit të Sektorit, ndërsa, më hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik më datë 05.02.2023, ku ende ka qenë në fuqi Rregullorja (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, atëherë për pozitën Zyrtare Certifikuese duhet të aplikohet koeficienti i pagës përcaktuar për pozitën udhëheqës i ulët drejtues, ku në të njëjtën mënyrë kishte vepruar edhe DMZP-ja me rastin ekuivalentimit të koeficientit të ankueses ku kishte miratuar koeficient 7.26.

Andaj, bazuar në rrethanat si më sipër, dhe meqenëse më datë 28.02.2024, ka hyr në fuqi Rregullorja (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, sipas së cilës pozita Zyrtar Certifikues klasifikohet si pozitë e kategorisë profesionale, atëherë, në ratsin konkret organi i punësimit gjegjësisht Agjencia për Akreditim ka vepruar drejtë me rastin e lëshimit të Akti të Emërimit të datës 02.08.2024, sipas klasës Profesional 1, klase dhe koeficient të pagës II2, 5.75, mirëpo, duke qenë së ankuesja para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat, ka fituar të drejtën në pagë e barasvlershme me pagën e udhëheqësit të ulët, atëherë, pas transferimit në Agjencinë e Akreditim (si institucione që ka të përfunduar procesin e ristrukturimit dhe klasifikimit) në raport me ankuesen gjejnë zbatim dispozitat të shtesës tranzitore sipas nenit 41 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, pra ankuesja duhet të realizoj pagë sipas IL2 - 5.75, por, me pagesë të shtesës tranzitore si diferencë ndërmjet koeficient 7.26 dhe 5.75.

Nisur nga fakti së e drejta e pagës, përben një nga të drejtat me themelore nga marrëdhënia e punës, Gjykata Kushtetuese bazuar në praktiken e saj të mëhershme, serish më Aktgjykimin për rastin Nr.KO79/23, ka ritheksuar së e drejta në pagë të fituar është e drejtë e pronës dhe ka të gjitha atributet e kësaj të drejtë të garantuar me kushtetutë, rrjedhimisht si e drejtë e pa tjetërsueshme, duke sqaruar përmes pikës 383 të aktgjykimit se: *Ndërsa, në balancimin në mes të drejtave dhe lirive themelore dhe parimit të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë, Gjykata, përmes këtij Aktgjykimi do të shpallë të pavlefshme dhe do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. Shfuqizimi i paragrafëve që ndërlidhen me periudhën tranzitore, bazuar në paragrafin 1 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar, ka pasojën e (i) mbajtjes së nivelit ekzistues të pagave në sektorin publik, përkatësisht pamundësinë e zbritjes së pagave deri sa paga e re të 110 bëhet e barasvlershme me pagën aktuale; (ii) kthimin e pagës të paktën në nivelin para hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar për kategorinë e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës dhe të cilët nuk kanë përfituar nga shtesa tranzitore prej njëqind për qind (100%) përgjatë vitit 2023, për dallim nga të gjitha kategoritë tjera; dhe (iii) nivelizimin e pagave të funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve që janë punësuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar sipas përcaktimeve të pikës 1.4 të nenit 4 (Parimet e sistemit të pagave) të Ligjit të kontestuar".* Kurse më pikën 385 të aktgjykimit, Gjykata Kushtetuese kishte saktësuar se: *"385. Bazuar në pretendimet dhe argumentet e parashtruara para saj, Gjykata nuk ka trajtuar Shtojcat që janë pjesë përbërëse e nenit 44 të Ligjit të kontestuar. Përkundër faktit që (i) bazuar në vet Ligjin të kontestuar, ulja e pagës mund të bëhet vetëm si rezultat i një tronditje makroekonomike e cila rezulton në zvogëlimin e të ardhurave dhe/ose një fatkeqësie natyrore sipas kuptimit të nenit*

131 të Kushtetutës, përkatësisht shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme në Republikën e Kosovës; dhe (ii) emëruesit të përbashkët të praktikës gjyqësore të Gjykatave tjera Kushtetuese, GJEDNJ-së dhe GJDBE-së, që ulja e pagës, në parim, mund të bëhet vetëm në rrethana të krizave ekonomike dhe/ose financiare, Gjykata ka vlerësuar qëllimin e Ligjit të kontestuar për të krijuar “një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik” si qëllim legjitim. Për pasojë, ajo nuk ka shpallur në kundërshtim me Kushtetutën nenin 44 të Ligjit të kontestuar përkitazi me Shtojcat në lidhje me paragrafin 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar që përfshinë shfuqizimin e një numri të dispozitave të ligjeve të veçanta dhe të cilat rregullojnë pagën e një numri institucionesh në Republikën e Kosovës. **Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, “një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik” arrihet përmes paragrafit 1 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar dhe sipas të cilit, nëse një zyrtar/e publik/e apo funksionar/e publik/e, para hyrjes në fuqi të këtij ligji përfitonte pagë që është më e madhe se paga e plotë e parashikuar me këtë ligj, ajo/ai do të përfitojë pagën e re sipas dispozitave të këtij ligji dhe shtesën tranzitore të barabartë me diferencën ndërmjet pagës aktuale dhe pagës së re bazë.**

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, gjegjësisht, aprovoj si të bazuar pretendimin lidhur me kompensimin e pagës së realizuar para transferimit të përhershëm, ndërsa, refuzohet pretendimi ankimor lidhur me klasifikimin e pozitës së ankueses në kategorinë drejtues i ulët dhe më koeficient 7.24 të pagës, mbetet në fuqi Akti i Emërimit të ankueses Nr. 1504/2024 i datës 02.08.2024, ndërsa obligohet Drejtori i Përgjithshëm dhe Njësia e Personelit, në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, që të ndërmarrin veprimet e nevojshme administrative, ashtu që ankueses t’i njihet e drejta në shtesë tranzitore ndërmjet koeficientit për kategorinë e ulët drejtuese të fituar dhe klasës profesionale 1, I12, 5.75, dhe të njëjtës ti behët kompensimi i difference së papaguar të shtesës tranzitore dhe atë nga muaji gusht 2024 e deri në zbatimin e këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.98/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses, E.R;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Akreditim; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.